



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21,22, 44, 140 dhe 157 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës **05 Nr.350/02-155484/19 dt.03.07.2019**, të pronarit Besim Latifaj, Rr."Hilmi Rakovica"nr.28, Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, në lagjen "Sofalia", Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 30.07.2019, merr këtë:

### V E N D I M

#### PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. I Caktohen kushtet ndërtimore** pronarit Besim Latifaj nga Prishtina, sipas kërkesës **05 Nr.350/02-155484/19 dt.03.07.2019**, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, me etazhitet P+1, në kuadër të bllokut urban "F-04", të tërësisë "F" të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.126-5,ZK.Sofali.

**II. Lokacioni** i parcelës kadastrale të lartcekura, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të: Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr.031-247790 të dt. 04.10.2016, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim "banim individual";

**III. Gjendja ekzistuese** e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
  - Parcela kadastrale nr.126-5 ZK. Sofali, me S=408.00m<sup>2</sup>, me pronar Besim Latifaj, me kulturë të tokës "Arë e klasës 5";
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale të lartcekura nuk ka ndërtime ekzistuese;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni është i pjerrët;
- Qasja në parcelë bëhet përmes rrugës ekzistuese dhe njëkosisht të planifikuar me Planin Rregullues të Hollësishëm "Sofalia".
- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale banimore dhe afariste.

**IV. Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia" në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelës, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të

*Pranoi: Fahrige Latifi  
D.: 1030878844*



- Destinimi i shfrytëzimit, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", është banim individual i ulët; (*sipas projektit konceptual të prezantuar*);
- Etazhiteti i shtëpisë individuale të banimit, sipas planit rregullues është max.P+2 etazhe, ndërsa sipas projekt propozimit etazhiteti i shtëpisë individuale është P+1;
- Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP), sipas planit rregullues është max.0.30 e sipërfaqes së parcelës;
- Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISPN), sipas planit rregullues është max.0.80;
- Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës (ISHN), sipas planit rregullues është max. 0.50;
- Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit (ISG), sipas planit rregullues është max. 0.50;
- Qasja në parcelë duhet të jetë nga rruga e planifikuar sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia";
- Distanca e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës, për kthina primare min. 0.5H, për kthina sekondare min.0.2H,dhe marrëveshja me fqinj deri në bashkim të plotë,
- Kuota e përdhesës së ndërtesës përcaktohet në raport me kuotën e niveletës së rrugës publike nga e cila ka çasje parcela, gjegjësisht në krahasim me kuotën zero,
- Kuota e përdhesës së ndërtesave të reja nuk mund të jetë më e ulët se kuota e niveletës së rrugës publike,
- Distanca në mes vijës ndërtimore dhe asaj rregulluese është 5.0 m;
- Nëse parcella ka pjerrësi tereni i tillë që mbulon më shumë sesa një kat në njërin drejtim, atëherë sipërfaqja ndërtimore llogaritet 50%.
- Nëse në fasadat e ndërtesës me orientim nga fqinjët kanë hapje sekondare si shkallë, depo, banjo e të tillë kthina të ngjashme, të cilat nuk kanë nevojë për diellzim, por vetëm për ndriçim dhe ajrosje, distanca minimale është 0.2h nga kufiri i parcelës.
- Nëse në fasadat e ndërtesës me orientim nga fqinjët nuk ka hapje ndriçim distanca minimale është 0.2h nga kufiri i parcelës. Por me pëlqim paraprak të fqinjëve, kjo distancë mund të zvogëlohet deri në bashkimin e plotë.
- Në raste kur forma nuk e mundëson ndërtimin me 5 metra distancë, do të mundë të lejohet ndërtimi edhe me 3 metra vijën ndërtimore. Kjo vlen vetëm për parcella që kanë qenë nën 4 ari (nën 400m<sup>2</sup>) para fillimit të hartimit të këtij plani.
- Me kërkesë të posaçme dhe duke marrë pëlqimin e qytetarëve në rreze prej 50m, mund të lejohet edhe ndërtimi i shërbimeve të tjera jo shqetësuese, me qëllime afariste, ndërmarrje tregtare, zejtare, fetare, kulturore, sportive etj duke përfshirë edhe hapësirat shërbyses.
- Kati përdhese i ndërtesës, për tu konsideruar kat i plotë, duhet të jetë së paku 1,4 m mbi sipërfaqen tokësore, duhet të ketë së paku 2/3 të sipërfaqes së vet në lartësi minimale prej 2,3 m;
- Për të siguruar pamje të përshtatshme dhe të organizuar të kulmeve në zonë, këndi i kulmeve të pjerrëta është kufizuar në maksimum 45°;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që uji i strehëve duhet të pikojë brenda parcellës kadastrale;
- Pamja e rrugës përcaktohet nga ndërtesat e ndërtuara, por në mënyrë vendimtare edhe nga lartësia e mureve fqinje, gardheve, dhe rrëthimeve tjera. Për ta parandaluar ndërhyrjen pamore të hapësirës së rrugës, lartësia është kufizuar në 1,5 m;
- Te shtëpitë me një familje, me shumë familje, dhe ndërtesat tjera banesore parashihet 1 vend parkim/njësi banimi;
- Qasja në parcellë të jetë nga rruga e planifikuar, të paraqitur në Planin e situacionit - "zgjidhja urbane" të parcellës;
- Në kuadër të parcellës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të eficiencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;

- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

**V. Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlgimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detaile dhe pëlgimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

**VI. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digitale dhe të përbajtë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjërë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrithinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhesë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe paralogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme;

**VII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcela kadastrale nr.126-5 ZK. Sofali, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "Arë e klasës 5", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë. Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe parcelës ndërtimore të caktuar me Planin Rregullues të Hopllësishëm 'Sofalia' e njëjtë do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, si në vijim: parcela kadastrale nr. 126-5, me S=408.00m<sup>2</sup>. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si



destinimit të tokes bëjcesore.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtoria e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

**VIII. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Konratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investorit);

**IX. Pagesa e taksës administrative** për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese, në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, sipas pikës 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënimit.

**X. Vlefshmëria** e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

## A r s y e t i m

Pronari Besim Latifaj nga Prishtina, me kërkesën **05 Nr.350/02-155484/19 dt.03.07.2019**, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, në lokacionin e përshkruar në paragafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore. Me kërkesë, pronarja ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr. 126-5, ZK. Sofali, kopje e noterizuara te noteri Faton Muslija, me LRP.Nr.1227/2019 dhe LRP.Nr.1228/2019;
- Vërtetimin e tatimit në pronë në emër të Fetah Latifaj, me LRP.Nr.123222/19 dt.29.05.2019;
- Autorizimin me anë të të cilit Besim Latifaj autorizon Fahrije Latifin, për përfaqësim para organeve kompetente.Autorizim ky I dhënë të noteri Mihail Florin Gavrila, Englan Unitet Kindgom, dhe i pëkthyer.

- Informatën nga plani me nr.05-350/01-88866/19 dt.18.04.2019, të lëshuar nga Drejtoria e planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- Incizimin gjeodezik, punuar nga "Selatin Ismaili, gjeodet. Me nr. Lic.45;
- Projektin konceptual për parcelën kadastrale në fjalë, të hartuar nga "B17 Architects" Sh.P.K.. nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810031162;
- Kopje e letërnjoftimit të pronarit dhe të autorizuarit.
- Fotot e lokacionit.

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës me **05 Nr.350/02-155484/19 dt.03.07.2019**, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, ka vendosur njoftimin me datë 23.07.2019 deri me dt.27.07.2019. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë dhe meqë ndërkojë kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sygjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas rishqyrtimit të kërkesës për cakimin e Kushteve Ndërtimore, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni (Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia"), rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënim i përkategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", projektit konceptual, ka konstatuar se kërkuesja ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", në Prishtinë për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrëthinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Plani i situacionit -"zgjidhja urbane", Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregullues dhe ndërtimore nga "Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", " në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01.


**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimet nga kjo drejtori, anesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

**Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet:** Kërkuesit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës **05 nr.350/02-91316/19 dt.19.04.2019**.

**Kopja elektronike i dërgohet:** Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**  
**05 NR. 350/02-155484/19 DT. 30.07.2019**

Zyrtar,  
Anita Osmani




u.d.Udhëheqëse e Sektorit  
Mimoza Berisha Prestreshi





SUPERFACIA / AREA:	408 m <sup>2</sup>	
TABELA / TABLE:		
RRUGA PLANIFIKUAR RRUGA EKZISTURESE		
<b>B17 architects</b> 		
PROJEKTOR: Majlinda KELMENDI PERPILINI GRAFIK: Majlinda KELMENDI NDERTEKA BUILDING: SHTEPI INDIVIDUALE ETAZHETI / PROJET COFACE AREA ADDRESS: P+1		
INVESTITOR / INVESTOR: BESIM LATIFAJ FAZA / PHASE: ARKITEKTURA FAZA PROJEKTI / PROJECT PHASE: PROJEKT KONCEPTUAL FERMBAJTA / VIZATIMI / DRAWING DESCRIPTION: QASJET NE LOKACION		
PERPIJESA / SCALE: 1:500 DATA / DATE: Korrik, 2019 NUMBER: A-06		

